



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:154353

Datë: 14.10.2022

Numri i dokumentit: 03529905

P.nr.983/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - gjyqtarja e vetme gjykuese Hakile Ilazi, me zyrtarin ligjor Ymri Ibrahimimi, në çështjen penale kundër të akuzuarve B. M. dhe K. K. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje zjarrvënia nga neni 322 par. 3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së dhe F. K. për shkak të veprës penale shtytja në kryerjen e veprës penale zjarrvënia nga neni 322 par. 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas Aktakuzës PP/II.nr.940/20 të datës 20.11.2020, të Prokurorisë Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe publik të mbajtur me datë 18.07.2022, në praninë e Prokurores së Shtetit Zana Sadiku Sertolli, përfaqësuesin me autorizim të të dëmtuarit G. U., av. Skender Musa, të cilin me autorizim zëvendësues e ka përfaqësuar bashkëpunëtori profesional G.H., përfaqësuesit me autorizim të të dëmtuarit B. I. av.Ramadan Sylejmani, të akuzuarit B. M. me mbrojtësin me autorizim av. Teuta Zhinipotoku, të cilën me autorizim e ka përfaqësuar av. Abit Asllani, të akuzuarit K. K. me mbrojtësin me autorizim av. Fitim Malokaj si dhe të akuzuarit F. K. dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. Arsim Bilalli, me datën 20.07.2022 në praninë e prokurorsë së shtetit Albana Parduzi mori dhe publikisht shpalli kurse me datë 19.09.2022 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

B. M., nga i ati N., e ëma S., e gjinisë M., i lindur më në Vushtrri, me adresë banimi në Rr. "D.", nr..., Vushtrri, ka të përfunduar shkollën fillore, me profesion llamarinë punues, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i republikës së Kosovës, mban numër personal

K. K., nga i ati F., e ëma A., e gjinisë A., i lindur me datë në Prishtinë, me adresë banimi në fsh. G. K. Prishtinë, i martuar, baba i dy fëmijëve, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mban numër personal

F. K., nga i ati Sh., e ëma E., e gjinisë P., i lindur më në Prishtinë, me adresë banimi në Rr. "A." nr..., komuna Prishtinë, ka të përfunduar Fakultetin e Arteve, me profesion instruktor i arteve marciale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mban numër personal

JANË FAJTORË

I

Të akuzuarit B. M. dhe K. K.

Se me datë 06.07.2020, rreth orës 05:00, në magjistralen Ferizaj-Prishtinë, gjegjësisht në restorantin "B.", të pandehurit në bashkëkryerje, me dashje, kanë ndezur zjarrin në restorantin e lartcekur, dhe atë pas marrëveshjes paraprake që të njëjtit kanë bërë me të pandehurin F. K. për shkak se ky i fundit kishte mosmarrëveshje të mëhershme me pronarin e këtij lokali - tani të dëmtuarin G. U., ashtu që për këtë arsyeje, të pandehurit natën kritike, rreth orës 04:00, fillimisht takohen të tre së bashku, ku nisen me veturën e markës "Golf .", ngjyrë e kaltër, gjatë rrugës ndalen në pikën e derivateve "R. P." në fsh. B., K. Lipjan, ku i pandehuri K. del nga vetura dhe mbush me benzinë një bidon 10 litërshe, pastaj vazhdojnë rrugën, ku shkojnë dhe veturën e parkojnë shumë afër lokalit - Restorantit "B.", ku i pandehuri F. K. qëndron në veturë, ndërsa të

pandehurit B. M. dhe K. K. dalin nga vetura dhe nga bagazhi marrin bidonin me benzinë, nga aty, këta të fundit fillojnë të ecin në këmbë në drejtim të restorantit, ku me të mbërritur në oborr të restorantit, i pandehuri B. vendos në fytyrë bluzën e tij ngjyrë të zezë, duke e mbuluar fytyrën, kurse i pandehuri K. i veshur me një duks të zi me kapelë në kokë me lidhëse të bardha përpara, si dhe me maskë (Anti-covid) të vendosur në fytyrë, ashtu që së bashku, përmes dritares së tualetit, arrijnë të futen brenda në restorant, ku pasi hynë në sallë, fillojnë duke spërkatur me benzinë divanet–separtet, tavolinat dhe gjithë sallën, e ndezin zjarrin dhe pastaj menjëherë largohen nga aty me veturën “Golf .”, në të cilën ishte duke i pritur i pandehuri F., nisen në drejtim të Prishtinës, e që si pasojë e këtij veprimi zjarri është përhapur në tërë objektin i cili përbëhet prej katër katesh-banesave, me ç’ rast është shkaktuar dëm material në vlerë rreth 111,000 euro, sipas Raportit për vlerësimin e pronave të paluajtshme, të datës 22.09.2020, së inxhinierit të ndërtimit P. B., -

- me këtë në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale Zjarrvënia nga neni 322 par. 3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

I akuzuari F. K.

Sepse, në ditën, kohën dhe vendin të përshkruar si në dispozitiv të parë të kësaj aktakuze, i pandehuri për shkak të mosmarrëveshjeve të mëhershme që kishte me të dëmtuarin G. U. – pronar i lokalit “B.”, me dashje ka shtytë dy të pandehurit B. M. dhe K. K., që të kryejnë veprën penale zjarrvënia, në atë mënyrë që disa orë para ngjarjes kritike, përkatësisht me datë 05.07.2020, rreth orës 23:00, i pandehuri, përmes një shoku të tij, e thërret dhe takohet me të pandehurin B., në restorant “V. M.”, që gjendet në magjistralen Prishtinë –Ferizaj (afër rrethit tek QMI), ku i pandehuri jep idenë dhe aty pajtohen për mënyrën e kryerjes së veprës penale, ndërkaq pas këtij takimi, i pandehuri F. shkon në shtëpinë e të pandehurit K., i cili ka qenë në arrest shtëpiak për vepër tjetër penale, e ku gjatë kësaj vizite që i bënë të njëjtit, aty edhe i tregon se është marrë vesh me B. lidhur me zjarrvënien, si dhe me të pandehurin K. merren vesh për kohën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, me ç’ rast natën kritike, pra pas marrëveshjes paraprake, të pandehurit B. dhe K. duke përdorur lëndën ndezëse – benzinë ia vënë flakën lokalit – Restorant “B.”,-

- me të cilën ka kryer veprën penale shtytja në kryerjen e veprës penale zjarrvënia nga neni 322 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70, të KPRK-së, dhe nenit 359 dhe 365 të KPPRK-së gjykon:

Të akuzuarin B. M.

Me dënim me burgim prej tri /3/ viteve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform dispozitave të nenit 79 të KPRK-së në dënimin e shqiptuar të akuzuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 19.08.2020 deri më datën 11.11.2020 si dhe në arrest shtëpiak nga data 11.11.2020 e deri me datën 01.12.2020. Pasi që i akuzuari nuk e ka respektuar masën e arrestit shtëpiak, gjykata të njëjti i ka caktuar sërish masën e paraburgimit nga data 04.02.2021 e deri me datën 18.07.2022.

Konform dispozitave të nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 100 /njëqind / euro në afatin prej pesëmbëdhjetë /15/ ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shumën prej 30 /tridhjetë/ eurove në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë /15/ ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për vlerën e dëmit të kërkuar, gjykata të dëmtuari G. U., me adresë banimi në Rr. "A. Q.", nr. ..., Fushë Kosovë B. I. me vendbanim në Ferizaj, rr."A. B." për realizimin e kërkesës pasurore-juridike i udhëzon në kontest civil.

Të akuzuarin K. K.

Me dënim me burgim prej tri /3/ viteve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform dispozitave të nenit 79 të KPRK-së në dënimin e shqiptuar të akuzuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 20.08.2020 deri më datën 11.11.2020 si dhe në arrest shtëpiak nga data 11.11.2020 e deri me datën 19.09.2022.

Konform dispozitave të nenit nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 100 /njëqind / euro në afatin prej pesëmbëdhjetë /15/ ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shumën prej 30 /tridhjetë/ eurove në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë /15/ ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Konfiskohet në mënyrë të përhershme DVR i kamerave të sigurisë.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për vlerën e dëmit të kërkuar, gjykata të dëmtuarit G. U., me adresë banimi në Rr. "A. Q.", nr. ..., Fushë Kosovë B. I. me vendbanim në Ferizaj, rr. "A. B." për realizimin e kërkesës pasurore-juridike i udhëzon në kontest civil.

Të akuzuarin F. K.

Me dënim me burgim prej tri /3/ viteve, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform dispozitave të nenit 79 të KPRK-së në dënimin e shqiptuar të akuzuarit do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 19.08.2020 deri më datën 11.11.2020 si dhe në arrest shtëpiak nga data 11.11.2020 e deri me datën 19.09.2022.

Konform dispozitave të nenit nenit 450 par. 1 dhe 2 pika 2.6 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPPRK-së obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 100 /njëqind /

euro në afatin prej pesëmbëdhjetë /15/ ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

Obligohet i akuzuari që të paguajë shumën prej 30 /tridhjetë/ eurove në Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit brenda afatit prej pesëmbëdhjetë /15/ ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për vlerën e dëmit të kërkuar, gjykata të dëmtuari G. U., me adresë banimi në Rr. "A. Q.", nr. ..., Fushë Kosovë B. I. me vendbanim në Ferizaj, rr."A. B." për realizimin e kërkesës pasurore-juridike i udhëzon në kontest civil.

II

Për të akuzuarin F. K.

Konform nenit 363 par.1 nën par 1.1, të KPPRK-së.

REFUZOHET AKUZA

Se me datë 06.07.2020, rreth orës 05:00, në magjistralen Ferizaj-Prishtinë, gjegjësisht në restorantin "B.", të pandehurit në bashkëkryerje, me dashje, kanë ndezur zjarrin në restorantin e lartcekur, dhe atë pas marrëveshjes paraprake që të njëjtit kanë bërë me të pandehurin F. K. për shkak se ky i fundit kishte mosmarrëveshje të mëhershme me pronarin e këtij lokali - tani të dëmtuarin G. U., ashtu që për këtë arsyeje, të pandehurit natën kritike, rreth orës 04:00, fillimisht takohen të tre së bashku, ku nisen me veturën e markës "Golf .", ngjyrë e kaltër, gjatë rrugës ndalen në pikën e derivateve "R. P." në fsh. ..., K. Lipjan, ku i pandehuri K. del nga vetura dhe mbush me benzinë një bidon 10 litërshe, pastaj vazhdojnë rrugën, ku shkojnë dhe veturën e parkojnë shumë afër lokalit - Restorantit "B.", ku i pandehuri F. K. qëndron në veturë, ndërsa të pandehurit B. M. dhe K. K. dalin nga vetura dhe nga bagazhi marrin bidonin me benzinë, nga aty, këta të fundit fillojnë të ecin në këmbë në drejtim të restorantit, ku me të mbërritur në oborr të restorantit, i pandehuri B. vendos në fytyrë bluzën e tij ngjyrë të zezë, duke e mbuluar fytyrën, kurse i pandehuri K. i veshur me një duks të zi me kapelë në kokë me lidhëse të bardha përpara,

si dhe me maskë (Anti-covid) të vendosur në fytyrë, ashtu që së bashku, përmes dritares së tualetit, arrijnë të futen brenda në restorant, ku pasi hynë në sallë, fillojnë duke spërkatur me benzinë divanet–separet, tavolinat dhe gjithë sallën, e ndezin zjarrin dhe pastaj menjëherë largohen nga aty me veturën “Golf .”, në të cilën ishte duke i pritur i pandehuri F., nisen në drejtim të Prishtinës, e që si pasojë e këtij veprimi zjarri është përhapur në tërë objektin i cili përbëhet prej katër katesh-banesave, me ç’ rast është shkaktuar dëm material në vlerë rreth 111,000 euro, sipas Raportit për vlerësimin e pronave të paluajtshme, të datës 22.09.2020, së inxhinierit të ndërtimit P. B., -

- me këtë në bashkëkryerje do të kryente veprën penale zjarrvënia nga neni 322 par. 3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Për shkak se prokurori i shtetit është tërhequr nga akuza në fjalën përfundimtare.

Pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për vlerën e dëmit të kërkuar, gjykata të dëmtuari G. U., me adresë banimi në Rr. “A. Q.”, nr.22, Fushë Kosovë B. I. me vendbanim në Ferizaj, rr.”A. B.” për realizimin e kërkesës pasurore-juridike i udhëzon në kontest civil.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.940/20 të datës 20.11.2020, ka ngarkuar të akuzuarit B. M., K. K. dhe F. K. për shkak të veprës penale në bashkëkryerje zjarrvënia nga neni 322 par. 3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së dhe të akuzuarin F. K. për veprën penale shtytja në kryerjen e veprës penale zjarrvënia nga neni 322 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, por në fjalën përfundimtare prokurorja e shtetit për të akuzuarin F. K. ka heq dorë nga ndjekja penale për veprën penale në bashkëkryerje zjarrvënia nga neni 322 par. 3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, por ka qëndruar pranë akuzës për veprën penale shtytja në

kryerjen e veprës penale zjarrvënia nga neni 322 par.3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke propozuar që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe t'u shqiptohet sanksion penal i paraparë me ligj.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar me datën 04.02.2021 si dhe shqyrtimet gjyqësore me datë 15.06.2021, 16.07.2021, 02.09.2021, 03.09.2021, 23.09.2021, 25.10.2021, 27.10.2021, 22.12.2021, 24.12.2021, 15.02.2022, 11.03.2022, 28.03.2022, 31.03.2022, 20.04.2022, 03.06.2022, 16.06.2022, 21.06.2022, 13.07.2022, 14.07.2022, dhe 18.07.2022 në të cilën shqyrtim te pranishëm ishin prokurorja e shtetit Zana Sadiku Sertolli, përfaqësuesi me autorizim i të dëmtuarit G. U., av. Skender Musa, të cilin me autorizim zëvendësues e ka përfaqësuar bashkëpunëtori profesional G.H., përfaqësuesi me autorizim i të dëmtuarit B. I. av.Ramadan Sylejmani, i akuzuari B. M. me mbrojtësin me autorizim av. Teuta Zhinipotoku, të cilën me autorizim e ka përfaqësuar av. Abit Asllani, i akuzuari K. K. me mbrojtësin me autorizim av. Fitim Malokaj si dhe i akuzuari F. K. dhe mbrojtësit të tij me autorizim av. Arsim Bilalli.

Pasi që të akuzuarit në shqyrtimin fillestar nuk e kanë pranuar fajësinë, me datën 03.03.2021, mbrojtësit me autorizim pranë kësaj gjykate kanë paraqitur kërkesë për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave me arsyetimin se aktakuza nuk është e mbështetur në prova të mjaftueshme. Gjykata nga një kopje ua ka dërguar prokurorit të shtetit për dhënien e përgjigjes lidhur me këto kërkesa mirëpo përkundër kësaj të njëjtit nuk kanë dhënë përgjigje për një gjë të tillë me ç'rast me aktvendim të kësaj gjykate me numër 2020:163558 të datës 11.03.2021 këto kërkesa janë refuzuar si të pa bazuara.

Mbrojtja e të akuzuarve në shqyrtimin gjyqësor

Në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtarja e vetme gjykuese i ka udhëzuar dhe njoftuar të akuzuarit B. M., K. K. dhe F. K. për të drejtat dhe detyrimet e tyre në kuptim të nenit 323 paragrafi 1 dhe 2 të KPPK-së. Pasi që të akuzuarit kanë deklaruar se i kanë kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me leximin e aktakuzës nga ana e prokurorës së shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar në tërësi aktakuzën, në pajtim me nenin 325 par.1 të KPPK-së, u ka ofruar mundësinë që të deklarohen lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprat penale për të cilën janë akuzuar.

I akuzuari B. M. me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tij si në shqyrtimin fillestar ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë dhe nuk e ndien veten fajtor për veprën penale që i është vënë në barrë nga ana e prokurorisë, ndërsa në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 09.07.2022 ka deklaruar se lidhur me rastin që i referohet aktakuza ka dhënë tri deklarata, por që qëndron pranë deklaratës së tij të dhënë në prokurori, duke shtuar se i kujtohet data gjashtë korrik e vitit 2020 për shkak të rastit që ka ndodhur dhe se atë natë ka qenë në banesën e tij kurse të nesërmen ka dëgjuar se është djegur restaurant “B.”.

Për djegien e këtij restoranti i akuzuari deklaron se është njoftuar nga F. U. të cilin e njeh nga vëllau i tij B. dhe se F. për djegien e restorantit në fjalë kishte mësuar nga Sh.H..

Tutje ka vazhduar mbrojtjen e tij i akuzuari duke deklaruar se para se të ndodh rasti këtë restorant e ka vizituar bashkë me F. U., E. A., F. R. dhe F. K., potencon faktin se këtë restorant ai e ka vizituar vetëm një herë, por që data nuk i kujtohet, shton se atë natë kur ka qenë në restorant E. dhe F. kishin revole me vete, ka qenë në dijeni për këtë dhe se i ka marrë revolet dhe i ka dërguar në automjetin “M. G C.”, pronë e F. U. . Tutje ai shton se ka qëndruar në veturë dhe nuk ka hyrë brenda, pasi që nuk i pëlqejnë vendet që kanë muzikë, deklaron se më pas ai ka shkuar për në banesën e tij, por që ora nuk i kujtohet.

I akuzuari në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se qëndron vetëm pranë deklaratës së dhënë në prokurori, por jo edhe të atyre të dhëna në Stacionin Policor me arsyetimin se ndaj tij është ushtruar dhunë e natyrës fizike dhe psikike nga katër zyrtarë policor, për çka edhe ka kërkuar ndihmë mjekësore në Qendrën Emergjente për shkak të lëndimeve që i ka pas në qafë.

Më tej- vazhdon mbrojtjen e tij i akuzuari, është e vërtetë se i ka parë videoincizimet e restorant “B.” në Stacionin Policor para se të jap deklaratë, se e ka ditur që pronarë të këtij restoranti janë tre ose katër persona, por që G. U. nuk e ka takuar më herët, por që në gjykatë ka mësuar se është njëri nga pronarët e restorantit të cekur më lartë.

Në mbrojtjen e tij i akuzuari deklaron është e vërtetë që me të akuzuarin F. K. është takuar afër rrethit të Lipjanit, afër “QMI-së”, por mohon të kenë biseduar rreth zjarrvënies në restorantin “B.” dhe se nuk i njeh personat që shihen në videoincizime.

I akuzuari K. K. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se para datës 06.07.2020 ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak, ndërsa në kohën kur ka dhënë deklaratën e datës 20.08.2020 ka qenë me masën paraqitje në Stacionin Policor duke deklaruar se më datën 06.07.2020 është vizituar nga F.i dhe F.u, por që nuk i kujtohet nëse ka qenë edhe F. duke pranuar se me F. K. janë djem të agjës dhe kanë raporte shumë të mira, por duke mohuar se e njeh të akuzuarin B. M..

Mbrojtjen e tij i akuzuari e ka vazhduar duke deklaruar se para se të ndodh kjo ngjarje ai është marrë më një biznes veturash me qera “R. a C. F. ..”, e duke mohuar që ndonjëherë të ketë pasur veturë të tipit “ Golf .” as ai po as edhe familjarët e tij.

Deklaron se për këtë rast që akuzohet është arrestuar në Stacionin Policor në Prishtinë derisa po jepte deklaratë dhe se më pas kanë shkuar në shtëpinë e tij në fshtin ..., ku edhe është kryer bastisja e shtëpisë së tij e cila ka zgjatur rreth dy orë dhe se më pas kanë vazhduar për në Stacionin Policor në Ferizaj dhe sipas tij gjatë rrugës sjellja e zyrtarëve policor ka qenë e tmerrshme.

I akuzuari mohon të ketë qenë ndonjëherë në restaurant “B.” apo edhe se i njeh pronarët e restaurantit në fjalë, por që të njëjtit i ka njoftuar në seancat gjyqësore.

Më tej vazhdon mbrojtjen e tij i akuzuari, i ka njoftuar zyrtarët policor për kamerat e sigurisë që kanë qenë të vendosura në shtëpizën ku ka qëndruar dhe se nuk e di se të kujt janë armët e gjetura në këtë shtëpizë, shton se është i martuar, i ka dy fëmijë gjashtë dhe tre vjeçar të cilët shpeshherë i ka dërguar te ferma e deleve ku gjendet edhe pjesa e lodrave, e që kjo pjesë ndodhet diku rreth katërqind metra deri te villa e tij.

Tutje i akuzuari e ka njoftuar gjykatën se me rastin e bastisjes së shtëpisë së tij nga aty janë marrë dy duksa, një palë patike me mbishkrimin “Diesel”, një DVR, e që sipas tij atij janë duksa të fermës e të cilët asnjëherë nuk i janë ofruar për të i provuar nëse i përshtaten apo jo. Deklaron se patiket, një orë dore dhe telefoni i janë kthyer, por jo edhe DVR.

I akuzuari F. K. në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 14.07.2020 ka deklaruar se i frekuenton lokalet e muzikës dhe e di se ku gjendet restaurant “B.” dhe se të njëjtin e ka frekuentuar mjaftë shpesh, aty ka qenë i mirëpritur pasi që aty ka punuar e dashura e tij me emrin A. N. me pesudonimin “S.”, Deklaron se ka pasur njohuri se aty kanë ndodhur vepra të ndryshme penale.

I akuzuari vazhdon deklaramiun e tij duke shtuar se me datën 04.07.2020 ka pasur një keqkuptim të vogël gjatë së cilës ka marrë disa goditje nga sigurimi i restaurantit “B.”, ku ka pësuar vetëm disa gërvishtje të vogla. Sipas të akuzuarit ky keqkuptim ka ardhur si rezultat se ai ka konsumuar pije alkoolike dhe se nuk ka pasur hatërmbetje.

Tutje vazhdon mbrojtjen i akuzuari duke shtuar se me datën 05.07.2020 ka qenë në lokal të muzikës “A.” dhe se më pas kanë vazhduar te villa “M.” afër “QMI” dhe aty ka qenë bashkë me F. U., F. R., E. A. dhe B. M.

Mohon që aty të jetë biseduar lidhur me zjarrvënien në restaurantin në fjalë, aty ka qenë bisedë e zakonshme dhe se pas kësaj ka vazhduar për në Fushë Kosovë, në banesën e tij aty ku e ka pritur e dashura e tij A. N., shton se nuk i kujtohet se sa ka qëndruar aty, më pas është takuar me F. U. ka shëtitur për një kohë në Prishtinë, kanë shkuar të pompa e derivateve “I. P.”, për të vazhduar më pas për në G. të Prishtinës për të vizituar djalin e axhes që gjendej në arrest shtëpiak.

Mbrojtjen e tij e vazhdon duke deklaruar se pastaj rreth orës 02:00 ose 03:00 të mëngjesit kanë shkuar ne Fushë Kosovë te banesa e “S.”, ndërsa sa i përket deklaramit të tij në Stacionin Policor, shton se fillimisht nuk i kanë ofruar për shikim videoincizimet, por të njëjtat i janë ofruar për shikim vetëm pas insitimit të avokatit të tij.

Krejt në fund i akuzuar e ka mohuar që të ketë kryer veprën penale të zjarrvënies apo që ta ketë shtytë dikë në kryerjen e kësaj vepre.

Provat e prezentuara në shqyrtimin gjyqësor.

Pasiqë të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë gjykata me qëllim të vërtetimit sa më të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në shqyrtimin gjyqësor ka bërë paraqitjen dhe vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të ndërlidhura mes vete në kuptim të nenit 361 par.1 dhe 2 të KPPK-së dhe gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata e ka vërtetuar në bazë të këtyre provave:

- Pjesërisht nga mbrojtja e të akuzuarve.

- Dëshmia e të dëmtuarit G. U. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 03.09.2021
- Dëshmia e dëshmitarit S. S. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 02.09.2021
- Dëshmia e të dëmtuarit B. I.e datës 23.09.2021.
- Dëshmia e dëshmitarit T. D. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 23.09.2021
- Dëshmia e dëshmitarit R. Sh. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 23.09.2021.
- Dëshmitari Z. M. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 27.10.2021 dhe në shqyrtimin e datës 22.12.2021.
- Dëshmia e të dëshmitarit F. K. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.12.2021.
- Dëshmia e të dëshmitarit Sh. H. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.02.2022.
- Dëshmia e dëshmitarit F. R e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 11.03.2022.
- Dëshmia e dëshmitarit E. A. e dhënë në shqyrtimin gjyqësor të datës 31.03.2022.
- Deklarata e të dëmtuarit -dëshmitarit G. U., e dhënë me datë 03.09.2020 në Prokurori si dhe deklarata e datës 06.07.2020 e dhënë para hetuesve policor,
- Deklarata e dëshmitarit S. S.e dhënë me datë 14.10.2020 në Prokurori dhe deklarata e datës 06.07.2020 e dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj,
- Deklarata e dëshmitarit R. Sh. të dhënë në prokurori më datë 16.09.2020;
- Deklarata e të pandehurit B. M., të dhënë më datë 31.07.2020 si dhe më datë 30.07.2020, në Stacionin Policor në Ferizaj,
- Deklaratat e të pandehurit K. K. të dhënë më dt.08.10.2020 në Prokurori si dhe dt.20.08.2020 në polici,
- Deklarata e të pandehurit F. K. të dhënë më datë 08.10.2020 në Prokurori dhe të dt.09.07.2020 në polici,
- Deklaratat e dëshmitareve A. N. të datës 03.09.2020 si dhe dëshmitares E. P., të datës 07.09.2020 , të dhëna në Prokurori.
- Deklarata e dëshmitarit T. D., të dhënë para hetuesve policor më dt.12.07.2020,
- Deklarata e dëshmitarit F. K., të dhënë para hetuesve policor më datë 19.07.2020,
- Deklaratat e dëshmitarëve F. U., F. R, E. A., Sh. H., të dhëna para hetuesve policor,
- CD me video-incizime të nxjerra nga kamerat e sigurisë në lokalin “B.” të dt.06.07.2020; CD me video-incizime të nxjerra nga kamerat e sigurisë së pikës së derivateve “I. P.” , të dt. 06.07.2020; CD me video-incizime të nxjerra nga kamerat e sigurisë nga “V. M.”, të dt. 05 - 06.07.2020; CD me video-incizime të nxjerra nga kamerat e sigurisë nga shtëpia e të pandehurit K. K. e cila gjendet në fsh. G., K. Prishtinë, të dt. 20.08.2020;

- Raporti i policisë për bastisjen e shtëpisë së të pandehurit K. K. të dt. 20.08.2020; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve; Raporti i hartografisë (hyrje-daljeve) në pikën kufitare Morinë, të dt. 06 - 09.07.2020 (për të pandehurin B. M.), Raporti me Foto-Album, i përpiluar nga Drejtoria e Teknikës Kriminallistike, të datës 20.08.2020; Raporti për vlerësimin e pronave të paluajtshme, të datës 22.09.2020, së inxhinierit të ndërtimit P. B., si dhe provat e tjera që gjenden në lëndë.
- Raporti për ekzaminimin-krahasimin e mbathjeve- patikave të K. K. i dt. 07.09.2020, i përpiluar nga Drejtoria e Teknikës Kriminallistike – Njësia Sektori për fotografi, videoanali dhe ekzaminimeve të TI (Teknologji Informative)
- Raporti për ekzaminimin e telefonit “I PHONE X MAX PRO” pronë e K.K. si dhe tel “Samsung” ngjyrë hiri pronë e të pandehurit B. M. dhe një DVR e dt. 04.09.2020 për kë dy telefonat, ndërsa për DVR e dt. 07.09.2020 i përpiluar nga Drejtoria e Teknikës Kriminallistike – Njësia Sektori për fotografi, videoanali dhe ekzaminimeve të TI (Teknologji Informative)
- Raporti i ekspertizës për telefonin e markës “I phone 8+” ngjyrë e zezë pronë e B. M. e dt. 14.08.2020 i përpiluar nga Drejtoria e Teknikës Kriminallistike – Njësia Sektori për fotografi, videoanali dhe ekzaminimeve të TI (Teknologji Informative)
- Raporti i ekspertizës për “Iphone 8” pronë e F.K. e dt. 10.08.2020 i përpiluar nga Drejtoria e Teknikës Kriminallistike – Njësia Sektori për fotografi, videoanalizë dhe ekzaminimeve të TI (Teknologji Informative)
- Raporti i ekspertizës për tel. e markat “I PHONE 11 PRO MAX”, e dt. 07.08.2020 i përpiluar nga Drejtoria e Teknikës Kriminallistike – Njësia Sektori për fotografi, videoanalizë dhe ekzaminimeve të TI (Teknologji Informative)
- Listingu i thirrjeve dhe përgjigjeve nga dt. 03 korrik 2020 deri më dt 09. Korrik 2020 të siguruar nga kompania “V.” e dt. 18.08.2020 e që ky raport i ka 24 faqe.
- UGJK me nr. ../20 e dt.08.07.2020 nga Gjykata Themelore Ferizaj Departamenti i Krimeve të Renda- Urdhër kontrolli i shtëpisë, banesave dhe Objekteve përcjellëse të të dyshuarit F. K.
- Vërtetimi i bastisjes së shtëpisë i dt. 09.07.2020;
- UGJK me nr. ../20 e dt. 25.08.2020 nga Departamenti i Përgjithshëm i lëshuar nga gjyqtarja e procedurës paraprake për sekuestrimin e përkohshëm të sendeve
- UGJK me nr. ../20 e dt. 14.07.2020 – Urdhër për sekuestrim të përkohshëm të sendeve dhe atë telefon “IPHONE 8” me nr. IM pronë e F. K.

- UGJK .../20 e dt. 14.07.2020 – Urdhëresa për regjistrim të thirrjeve telefonike (përfshire regjistrin e hyrjeve dhe daljeve vetëm sms për tel. e F. K.)
- UGJK me nr. .../20 e dt. 21.07.2020- Urdher për sekuestrim te përkohshëm të sendeve e tel “I PHONE 11 PRO MAX” pronë e F. K..
- UGJK me nr. .../20 e dt. 03.08.2020 – Urdhër për sekuestrim te përkohshëm te sendeve dhe ate tel e markës “I PHONE 8+” pronë e B. M.
- UGJK me nr. .../20 e dt. 14.08.2020- Urdhërese për masa të fshehta teknike të vëzhgimit dhe hetimit gjegjësisht regjistrim i thirrjeve telefonike, dhe nxerrja e SMS me Hartografi me nr. 044, 044 dhe 044 NN
- UGJK me nr. .../20 e dt. 19.08.2020 0- urdhërese për kontroll të shtëpisë dhe objekteve përcjellëse në fsh. G. Komuna Prishtinë.
- UGJK me nr. .../20 e dt. 14007.2020 urdhëresa për regjistrim të thirrjeve telefonike (përfshire regjistrim të hyrje daljeve dhe SMS për nr. 045 përdorues F. K.)
- Raporti mbi zjarrin me nr 03-.../2020 e dt. 06.07.2020 e përpiluar nga Drjetoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë, gjegjësisht shërbimi zjarrfikës dhe shpëtimit Zyra e preventivës dhe hetuesisë në Ferizaj.

Gjykata në cilësinë e dëshmitarit ka dëgjuar të dëmtuarin G. U. i cili në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se në restaurant “B.” punon afër dy viteve duke shtuar se dy javë para se të digjej lokali ka pasur probleme me F. K., B. M., E. A., F. U. dhe disa të tjerë, deklaron se të njëjtit kur kanë shkuar në restaurant sjellja e tyre ka qenë jo e mirë, janë sjellë si “gangstera” dhe “kapadai”, kanë dashur të futen në restaurant pa kontrollë, por që rregulli i tyre është që askush të mos hyjë brenda pa asnjë kontroll.

Më tej i dëmtuari shton se gjatë kontrollit që kanë bërë te F. U. kanë gjetur një revole, të cilën e ka dërguar tek vetura e tij. Deklaron se F.i ka qenë në restaurantin “B.” edhe më herët, pra para datës 06.07.2020, por që gjithmonë sjelljet e tij kanë qenë provokative, ku konkretisht i dëmtuari deklaron se F.i ka pasur probleme me një djalë të Kaçanikut, T., të cilin i akuzuari F. K. dhe shoku i tij F. e kanë shoqëruar deri në banjo dhe i janë drejtuar me fjalët se “*pse po e nguc femrën time A. apo S. N.*”.

Sa i përket kësaj ngjarje i dëmtuari deklaron se e njëjta ka ndodhur me datën 04.07.2020, ku F. dhe F. K. kanë shkuar te mysafiri me emrin T., të njëjtit i janë drejtuar me shprehjen “*pse po*

vallëzohet me A. N.” dhe se më pas bashkë me sigurimin e lokalit “B.” i kanë laruguar nga lokali dhe pas largimit i kujtohet që F.i i është drejtuar me fjalët “ *kush jeni ju me më largu nga lokali?*”. Potencion faktin se K. K. nuk e ka parë asnjëherë dhe nuk e njeh, por që B. M. e ka parë para dy jave, në rastin kur kanë dashur të hyjnë në restaurant pa u kontrolluar.

I dëmtuari e njofton gjykatën se kanë pas kërcënime se F. K. dhe F. U. me punëtorët e vet do ta djegin lokalit duke shtuar se këto kërcënime i kanë pranuar përmes telefonit.

Sa i përket datës 06.07.2020, i dëmtuari deklaron se kanë punuar në restaurant afërsisht deri në orën 03:00, në lokal ka pasur kamera të sigurimit funksionale dhe roje të sigurimit të cilët kanë punuar deri në orën 04:00 atëherë kur janë larguar mysafirët dhe stafi. Atë natë i dëmtuari shton se kanë vërejtur diçka të pazakonshme, konkretisht veturën “M. G C.”, pronë e F. U., e cila ka lëvizur para lokalit herë me një shpejtësi të zvogëluar e herë të rritur krejt kjo si kërcënim se janë para lokalit, kjo veturë nuk është ndaluar për të biseduar me askënd dhe se brenda saj ka pasur edhe persona të tjerë.

Dëshminë e tij i dëmtuari e ka përfunduar duke deklaruar se personat që e kanë djegur lokalit e tij kanë hyrë përmes dritares së banjos, se aty është djegur i gjithë inventari, katër banesat mbi lokal e deri në çati të lokalit.

Në këtë çështje penale dëshminë e tij e ka dhënë edhe S. S. cili në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës së dhënë në Stacionin Policor, të dëmtuarin G. U. e njeh pasi që ka afër dhjetë vite që punon në restaurantin e tij. Në natën kritike dëshmitari ka deklaruar se në restaurantin “B.” ka qëndruar deri në orën 03:30 pas mesnate dhe se gjatë kësaj periudhe ka vërejtur diçka të parregullt, konkretisht se i dëmtuari G. U. ka pasur kërcënime përmes telefonit e që këto kërcënime i ka bërë F. K. bashkë me shokët e tij. Pas këtyre kërcënimeve dëshmitari vazhdon se kanë dalë bashkë me G. para lokalit, ora ka qenë rreth 01:30 dhe në ato momente kanë vërejtur një veturë “M. G C.”, ngjyrë e zezë të cilës nuk ka mundur të ia shoh targat, distanca e kësaj veture me ata sipas dëshmitarit ka qenë diku rreth 15 m.

Tutje vazhdon dëshmitari kanë qëndruar bashkë me G. para lokalit derisa kanë shkuar mysafirët, konkretisht deri në orën 03:30 kur edhe është mbyllur lokali dhe se secili më pas ka vazhduar për në shtëpi me veturat e veta.

Në vazhdim dëshmitari ka deklaruar se në momentin kur ka dashur të kyçet në magjistralen Ferizaj-Lipjan, i dëmtuari G. i ka tërhequr vëmendjen duke i rënë borisë së veturës , e ka hapur dritaren dhe i dëmtuari e ka njoftuar se në ato momente sërish ka tejkaluar automjeti “M. G C.” që edhe më herët ka kaluar kah restaurant “B.”. Më pas shton dëshmitari, i është vënë pas veturës për ta përcjellur, kanë arritur deri te “QMI”, por të cilin nuk ka mundur ta arrijë dhe më pas duke u kthyer kur ka arritur në fshatin B., te hyrja e autostradës e ka parë një veturë të markës “Golf .”, ngjyrë e kaltërt e mbylltë. Aty ka vërejtur se ka qenë një pasagjer, dhe një person në pozitën ulur-kacul që ka qenë më fytyrë në drejtim të Prishtinës, e që sipas tij ky person është i akuzuari B. M., i cili e ka pasur vesh një duks me lidhëse përpara, duke shtuar se më pas është takuar më të dëmtuarin G. të cilit edhe i ka rrëfyer se çka ka parë.

Dëshminë e tij dëshmitari e ka vazhduar duke deklaruar se bashkë me punëtorin e sigurimit B... dhe të dëmtuarin kanë qëndruar në parkingun e restaurantit deri në orën 04:55 dhe kur ka shkuar në shtëpinë e tij rreth orës 05:25 e ka marrë një njoftim nga G. se është duke u djegur restaurant “B.”.

Dëshminë e tij dëshmitari e ka përfunduar duke theksuar se pas djegies së restaurantit, i dëmtuari e ka njoftuar se ka pasur kërcënime të dërguara në formë mesazhi nga një numër i panjohur, të cilat mesazhe ai i ka parë dhe në to shkruhej “ *ti me qel lokalin, e djemtë tonë në burg nuk shkon, i ke 24 orë me e mbyll lokalin se këtë e ki-lokalin ta ka djeg F. U.*”.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 23.09.2021 ka dëshmuar edhe B. I., cili ka deklaruar se me të dëmtuarin G. U. janë në mardhënie shoqërore, merret me muzikë dhe se është pronar i lokalit “DPZ P. S. C”.

Të dëmtuarin dëshmitari deklaron se njeh si njeri të punës dhe se me të ka arritur marrëveshje gojore për të i vendosur paisjet muzikore ne restaurant “B.” dhe se këto mjete-pasije janë vendosur një vit para se të digjet restuaranti.

Për djegien e restaurantit dhe paisjeve muzikore aty dëshmitari ka deklaruar se është njoftuar nga dy shokë të tij A. R. dhe V., të cilët punojnë si kamerierë në restaurantin në fjalë, duke shtuar poashtu se edhe atij i është shkaktuar një dëm i madh në shumën prej afër tridhjetëmijë euro.

Në këtë shqyrtim gjyqësor si dëshmitar është dëgjuar edhe T. D. i cili ka deklaruar se është e vërtetë se resaurantin të cilit i referohet aktakuza e ka vizituar mjaftë shpesh, e gjithashtu i kujtohet se me datën 04 korrik 2020 ka qenë në restaurantin në fjalë, aty ka shkuar rreth orës 24:00 bashkë me dy shokët e tij N. Zh. dhe B. R..

Tutje vazhdon dëshmitari kur ka shkuar në toalet, i është ofruar një person, i cili i ka thënë që të mos flas me “S.”, pasi që ky person “S.” e njeh që pesë vite dhe se nëse ajo thotë diçka personi sipas dëshmitarit e ka obliguar që të thotë se “ *mue më ka thënë F.i kështu që mos me fol me juve, gjegjësisht me “S.”*”.

Dëshmitari ka deklaruar se i ka thënë këtij personi se gjithçka është në rregull dhe nuk ka problem dhe se pasi është ulur në tavolinën e tij, i akuzuari F. ka shkuar për të dytën herë duke iu afruar te veshi dhe duke iu drejtuar me fjalët “ *vepro si po të them që të mos kemi problem*”, pra që të mos i flasë “S.”.

Më pas deklarimin e tij dëshmitari e ka vazhduar duke dëshmuar se më vonë ka ardh G.-pronari i lokalit dhe bashkë me sigurimin e kanë nxjerrë jashtë të akuzuarin F. dhe se diku tridhjetë-katërdhjetë minuta pas largimit të F. edhe ai me shokët e tij kanë vazhduar për në shtëpi.

Në shqyrtimin e datës 23.09.2021 është dëgjuar edhe dëshmitari R. Sh. i cili në dëshminë e tij ka deklaruar se për të akuzuarin B. M. ka qenë i caktuar si mbrojtës sipas detyrës zyrtare (avokat) si në Stacionin Policor ashtu edhe në seancën dëgjimore te gjyqtari i kësaj gjykate E. Z..

Tutje dëshmitari e ka njoftuar gjykatën se me datën 30.07.2020 ka qenë prezent kur ish i mbrojturi i tij B. M. është marrë në pyetje nga ana e zyrtarëve policor, aty kanë qenë dy zyrtarë policor, por që më vonë kanë ardhur edhe dy zyrtarë të tjerë, duke shtuar se sjellja e tyre ka qenë korrekte, normale, nuk është ushtruar presion në të akuzuarin B. M. dhe se nuk ka pasur ndonjë vërejtje sa u përket zyrtarëve policor. Gjithashtu dëshmitari ka deklaruar se në cilësinë e mbrojtësit sipas detyrës zyrtare e ka nënshkruar procesverbalin e marrjes së deklaratës nga i akuzuari B. M. dhe se i kujtohet që zyrtarët policor i kanë pyetur nëse ka nevojë që ky procesverbal të lexohet, por që nuk i kujtohet nëse i akuzuari B. M. e ka lexuar apo jo të njëjtin.

Në radhën e dëshmitarëve të propozuar nga mbrojtja është dëgjuar edhe dëshmitari Z. M., i cili në shqyrtimin gjyqësor të datës 27.10.2021 ka deklaruar se në Policinë e Kosovës punon që nga

viti 2005, ndërsa në sektorin e hetimeve që nga viti 2015, thekson faktin se me datën 06.07.2020 ka qenë në punë me orar të zgjatur prej dymbëdhjetë orësh duke shtuar se e di ku ndodhet restaurant “B.”, ndërsa sa i përket rasisit që i referohet aktakuza dëshmitari ka deklaruar se është informuar nga shefi i ndërrimit dhe se fillimisht e kanë intervistuar të dëmtuarin G. U..

Sa i përket arrestimit të të akuzuarit F.K. dëshmitari ka potencuar se ai ka qenë bartës i lëndës, kurse shefi i policisë ka qenë udhëheqës i operacionit dhe në vazhdimësi dëshmitari ka rrëfyer para gjykatës se të gjitha veprimet i kanë marrë në koordinim me prokurorin e shtetit.

Radha e dëgjimit të dëshmitarëve ka vazhduar me dëgjimin e dëshmitarit F.K., i cili në shqyrtimin gjyqësor të datës 24.12.2021 ka theksuar se të akuzuarin F.K. e njeh në kohë të gjatë, me të ka raporte shumë të mira shoqërore dhe se shumë shpesh e kanë vizituar restaurant “B.”, aty gjithmonë janë pritur mirë dhe se kurrë nuk ka pasur telashe.

Herën e fundit sipas dëshmitarit ka pasur mosmarrëveshje dhe se atë natë ka qenë vetëm me F.. Gjithashtu deklaroi se sjelljet e të akuzuarit F. në lokal-restaurant kanë qenë shumë të mira dhe se nuk i kujtohet nëse ai është ofruar apo jo të ndonjë tavoline.

Dëshmitari ka deklaruar se mosmarrëveshje me punëtorin e sigurimit, B. Xh. kanë pasur edhe me rastin e pagesës, F. sipas tij nuk e ka kërcënuar askënd, por kur kanë dal jashtë gjithnjë sipas të dëmtuarit janë sulmuar sërish, ata janë munduar të mbrohen, por që kanë marrë goditje të shumta.

Në vazhdim të dëshmisë së tij dëshmitari ka deklaruar se nuk i kujtohet se ku kanë shkuar më pas, gjithnjë duke theksuar se F. asnjëherë nuk i ka thënë atij se do t'i vëj zjarrin restaurantit-lokalit.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 15.02.2022 është dëgjuar edhe Sh.H., i cili ka deklaruar se lidhur me rastin në fjalë ka dhënë dy deklarata, datat nuk i kujtohen, por që në Stacionin Policor në Ferizaj është ndaluar si i dyshuar.

Tutje dëshmitari deklaroi se është e vërtetë që në diskotekën “B. C.” është takuar me G. U., B. dhe Z. G., aty kanë biseduar me G. dhe B., ndërsa zyrtarin policor vetëm e ka përshëndetur.

Ky takim- vazhdon dëshminë dëshmitari, ka ndodhur pas dhënies së deklaratave dhe se me G. ka biseduar për rastin e ndodhur duke e mohuar se e njeh K. K..

Sa i përket djegies së restaurantit “B.” dëshmitari fillimisht ka deklaruar se nuk i kujtohet se si është informuar, por më vonë në dëshminë e tij deklaroi se atë natë ka qenë duke u kthyer nga Shkupi kur edhe e ka parë restaurantin duke u djegur. Më pas dëshmitari deklaroi se nuk është ndaluar, por ka vazhduar për në B., ku edhe është ndaluar te “H. P.” dhe aty është takuar me një shok të tij, D. D.. Sipas dëshmitarit ai e ka njoftuar shokun e tij për zjarrin e vënë në restaurant “B.”, më pas shoku i tij e ka thirr të dëmtuarin G., i cili pas pak kohësh ka shkuar aty dhe u ka treguar se dikush i ka vënë zjarrin restaurantit të tij por që nuk e di se kush.

Në shqyrtimin gjyqësor të datës 11.03.2022 është dëgjuar edhe F. R i cili ka deklaruar se lidhur me rastin e ndodhur në Ferizaj ka dhënë dy herë deklaratë në Stacionin Policor në Ferizaj duke shtuar se me datën 05.07.2020 ka qenë të villa “M.” bashkë me F., F.i, B.i dhe E. A., aty kanë qëndruar deri në orën 24:00 dhe se biseda që është zhvilluar aty ka qenë krejt e zakonshme. Në dëshminë e tij dëshmitari gjithashtu ka deklaruar se gjatë qëndrimit aty i akuzuari F. nuk e ka përmendur nëse ka pasur mosmarrëveshje te restaurant “B.”.

Pasi janë larguar nga aty dëshmitari deklaroi se e ka dërguar të akuzuarin F. në Fushë Kosovë në lagjen “D.”, pasi që aty ka qëndruar e dashura e tij, duke theksuar se më gjatë asaj mbrëmje nuk e ka takuar të akuzuarin F. K.

Radha e dëgjimit të dëshmitarëve ka vazhduar me E. A., i cili në shqyrtimin gjyqësor të datës 31.03.2022 ka deklaruar se lidhur me rastin në fjalë ka dhënë dy deklaratë në Stacionin Policor në Ferizaj, një të dyshuar, kurse tjetrën si i dëshmitar. Edhe ky dëshmitar ka pohuar faktin se me datën 05.07.2020 kanë qenë te restaurant “M.”, afër “QMI-së”, aty ka qenë bashkë me F.i, F., B., F. dhe të tjerët nuk i kujtohen.

Gjatë qëndrimit aty dëshmitari deklaroi se nuk kanë biseduar për diçka të veçantë dhe se biseda aty ka qenë e zakonshme, e poashtu ka theksuar se nuk ka vërejtur ndonjë shqetësim apo agresivitet tek F.i atë mbrëmje.

Në deklaratën e dhënë në hetuesi me datën 08.07.2020, dëshmitari F. U. ka deklaruar se para një muaji bashkë me disa shokë të tij kishte shkuar në lokalin “B.”, bashkë me të ka qenë edhe F. K.

E. A., B. M. dhe F. R, aty kishin shkuar me dy vetura, ndërsa dëshmitari ka qenë me veturën e tij të markës “M. G C.”.

Më tej dëshmitari ka deklaruar se kur kanë shkuar te hyrja e lokalit kanë hasur në një pengesë, pasi që njëri nga shokët e tij (nuk e di se cili) kishin pasur një armë të ftohtë, më pas kanë hyrë brenda dhe kanë qëndruar afër pesë minuta e më pas janë larguar.

Tutje dëshmitari ka deklaruar se nga kjo kohë ai nuk ka qenë në këtë lokal, por me datën 06-07-2022 ai e ka frekuentuar magjistralen Ferizaj-Prishtinë, me sa i kujtohet ora ka qenë 03:50 apo 04:00 kur ka shkuar afër pompës së derivateve “P.”e më pas ka vazhduar në drejtim të Prishtinës, gjatë rrugës është ndal të “H. P.”, afër ‘QMI-së”, por aty ka qëndruar vetëm dy minuta dhe është nisur në drejtim të Prishtinës. Gjatë tërë kësaj kohe bashkë me të ka qenë edhe shoku i tij F. R dhe pasi që ky-F. e kishte lënë makinën e tij tek “I. P.”, te “K.e.V.” në Prishtinë, aty ka zbritur F. ndërsa dëshmitari ka deklaruar se më pas ka vazhduar për në shtëpinë e tij, ku aty ka arritur rreth orës 04:35.

Dëshmitarja A. N. në deklaratën e saj të dhënë në Prkurorinë Themelore në Ferizaj me datën 02.09.2020 ka deklaruar se në restaurant “B.” ka filluar të punoj si balerinë që nga muaji shkurti i vitit 2020, ndërsa sa i përket datës 04.07.2020 deklararon se e ka pasur datëlindjen dhe e ka festuar në restaurant bashkë me shoqet e punës duke shtuar se aty ka qenë prezent edhe i akuzuari F. pasi që me të gjendet në lidhje dashurie tash e katër vite.

Dëshmitarja poashtu ka shtuar se nuk i kujtohet nëse atë natë F.i ka pasur ndonjë mosmarrëveshje, por që më vonë ka dëgjuar se F.i kishte pasur një mosmarrëveshje me një person të cilin ajo nuk e ka njohur, duke shtuar poashtu se pas festës që e kanë bërë ajo me taksit ka udhëtuar në një hotel “R.” në Fushë Kosovë.

Sa i përket të akuzuarit F. dëshmitarja ka deklaruar se e ka kuptuar se ai kishte shkuar në banesën e saj ku ka jetuar në Fushë Kosovë dhe kur ka shkuar të nesërmen aty ishte edhe F.i i cili kishte shkuar në banesë rreth orës 00:00 të datës 05.07.2020 dhe ka qëndruar aty deri në orën 13:00 të datës 06.07.2020 dhe aty bashkë me ta ka qëndruar edhe vajza e M., E..

Nga banesa e saj në Fushë Kosovë dëshmitarja ka deklaruar se është laruar me datën 06.07.2020, pasi që nuk ka mundur të paguajë edhe më tej qeranë, ndërsa punën e saj në restaurant “B.”

deklaruar e ka ndërprerë me arsyetimin e se është njoftuar se nga data 05.07.2020, lokali nuk do të punoj dhe do të mbyllet pasi që ishte kohë pandemie. Dëshmitarja e ka mohuar që punën e ka ndërprerë për shkak të fjalosjes që ka pas i dashuri i saj F.i, duke mohuar se e njen F. U., K. K. apo ndonjë shok tjetër të F.i, ndërsa sa i përket zjarrvënies në restaurantin “B.”, dëshmitarja ka deklaruar se është njoftuar nga F.i pasi që ishte marrë në pyetje nga policia.

Dëshmitarja E. P. në deklaratën e saj të dhënë në prokurori ka deklaruar se A. N. apo “S.” e njeh në kohën kur ajo ka shkuar të jetoj në banesën e tyre për shkak se nuk ka pasur mundësi që ta paguajë qeranë e banesës, e di se A. e ka pasur një të dashur me emrin F., shton se F.i në banesën e tyre ka shkuar disa herë, ka pasur raste kur dëshmitarja vetëm e ka takuar, është përshëndetur me të, por që nuk ka qëndruar gjatë aty dhe më pas ka kaluar në dhomën e saj.

Gjithashtu dëshmitarja ka deklaruar se i kujtohet që me datën 04.07.2020 “S.”-A. e ka pasur datëlindjen dhe pasi që e ka uruar, S. ka vazhduar për në punë dhe me datën 05.07.2020, mami i saj ka shkuar në punë rreth orës 21:00, ndërsa diku pas njëzetë minutash është kthyer edhe S., ajo ka qenë vetëm, kanë filluar të bisedojnë dhe pas një kohe shumë të shkurtër ka ardhur edhe F.i dhe më pas dëshmitarja ka vazhduar në dhomën e saj dhe se nuk i kujtohet sa ka qëndruar F.i aty.

Deklaratën e saj dëshmitarja e ka përfunduar duke deklaruar pas asaj nate F.i asnjëherë nuk ka qenë më në banesën e tyre dhe se nuk i kujtohet nëse me datën 05.07.2020, i akuzuari F. ka qenë apo jo i shoqëruar nga ndonjë shok i tij.

Fjala përfundimtare e palëve

Prokurorja e shtetit Zana Sadiku Sertolli në fjalën e saj përfundimtare ka bërë ndryshimin e pikës së parë të aktakuzës për të akuzuarin F. K. i cili tani akuzohet vetëm për veprën penale shtytja në kryerjen e veprës penale zjarrvënia nga neni 322 par.3 lidhur me par.1 dhe me nenin 32 të KPRK-së, ngase pas shtjellimit të të gjitha provave është vërtetuar fakti se i akuzuari F. K. ka shtytë të akuzuarit B. M. dhe K. K. të ndërmarrin veprime të kundërligjshme kundër pasurisë së paluajtshme të të dëmtuarit G. U., ndërkaq nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprën penale zjarrvënia nga neni 322 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Tutje prokurorja në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës pasi që fakti se të pandehurit janë kryerës të veprave penale për të cilat akuzohen vërtetohet më së miri dhe përtej dyshimit të bazuar mirë dhe se gjendja faktike është vërtetuar dhe mbështetur nga provat që i janë bashkangjitur aktit akuzues si dëshmia e të dëmtuarit G. U., nga dëshmitë e dëshmitareve S. S., Z. M., R. Sh. poashtu edhe nga dëshmia e të dëmtuarit tjetër B. I., pastaj nga dëshmia e dëshmitarit T. D., pjesërisht nga deklaratat e dëshmitarëve F. R dhe E. A. si dhe pjesërisht nga deklaratat e tani të pandehurve B. M., K. K. dhe F. K.

Prokuroria poashtu thekson se gjendja faktike më së miri është vërtetuar dhe nga provat materiale që janë propozuar në aktakuzë dhe që janë shtjelluar gjatë shqyrtimeve gjyqësore si CD me videoincizime të nxjerra nga kamerat e restaurant “B.” të datës 06.07.2020, pastaj CD-të me videoincizime të nxjerra nga kamerat e sigurisë së pikës së dervateve “I.P.” të datës 06.07.2020, CD-të me videoincizime të nxjerra nga kamerat e sigurisë së “V. M.”, të datës 06.07.2020, pastaj nga provat materiale si raporti i policisë për bastisjen e shtëpisë së të pandehurit K. K. datës 20.08.2020, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, raporti i hartografisë në pikën kufitare Morinë i datës 06-09.07.2020 për të pandehurin B. M., raporti me fotoalbum i përpiluar nga Drejtoria e Teknikës Kriminolistike të datës 22.09.2020 së inxhinierit të ndërtimit P. B. si dhe provat e tjera që gjenden në lëndë.

Gjithashtu prokurorja në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se dyshimin e bazuar mirë se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar e mbështet edhe në provën materiale- deklarimin e të pandehurit B. M. të dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj me datë 31.07.2020, ndonëse i njëjti pastaj e ka ndryshuar deklaratën e tij si në fazën hetimore ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka kërkuar nga gjykata që dëshmisë së të dëmtuarit dhe dëshmitarëve S. S. Z. M. dhe R. Sh. t’ua shpreh besimin e plotë, e poashtu edhe provat materiale që janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës të merren për bazë në tërësi.

Sa i përket dëshmive të dëshmitarëve F. R dhe E. A., prokuroria konsideron se të njëjtit janë munduar që të akuzuarin F. K. të mos e përfshijnë në rast si dhe ka kërkuar nga gjykata që deklaratave dhe mbrotjtjes të të pandehurve B. M., K. K. dhe F. K. të mos ua shpreh besimin pasi që të njëjtat kanë qenë në drejtim të shmangies së përgjegjesisë penale.

Në fjalën e saj përfundimtare prokurorja e shtetit i ka propozuar gjykatës që si rrethanë rënduese të merr, shkallën e lartë të dashjes me rastin e kryerjes së veprës penale, pasojën e shkaktuar, përkatësisht dëmin material të shkaktuar e i cili është rreth dyqindmijë euro (200,000 €), pastaj personalitetin e të akuzuarve, pasi që të njëjtit janë përsëritës të veprave penale, e në veçanti gjykata sipas prokurorisë duhet të marrë parasysh mosrespektimin e arrestit shtëpiak nga i akuzuari B. M..

Andaj duke i marrë për bazë të gjitha ato që u cekën më lartë, prokuroria i ka propozuar gjykatës që të njëjtit t'i shapll fajtorë dhe të i dënoj sipas ligjit.

Përfaqësuesi me autorizim i të dëmtuarit G. U., av. Skender Musa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se në këtë shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit në bashkëkryerje i kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe se një gjë e tillë është vërtetuar nga dëshmitë e dëshmitarëve si dhe nga provat tjera materiale. Gjithashtu i ka kërkuar gjykatës që të nxjerrë aktgjykim me të cilin të akuzuarit shpallen fajtor dhe të urdhërojë të akuzuarit që të dëmtuarit t'ia kompenzojnë dëmin e shkaktuar ashtu siç është përshkruar edhe në ekspertizën që është pjesë e shkreave të lëndës dhe atë në shumën prej njëqindnjëmbëdhjetëmijë euro (111.0000,00€), pasi që në procedurë civile procesi do të zvarritej shumë.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit i ka kërkuar gjykatës me rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh shakallën e rrezikut që paraqesin këta të akuzuar për shoqërinë kosovare dhe qytetarët e saj, dashjen e drejtpërdrejtë për ta kryer veprën penale, motivin e ulët të hakmarrjes si dhe të ketë parasysh edhe faktin se dënimi do të ndikoj në rehabilitimin e tyre për shkak se në bazë të së kaluarës së tyre kriminale janë persona të rrezikshëm.

Përfaqësuesi me autorizim i të dëmtuarit B. I., av. Ramadan Sylejmani në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se në këtë shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar, duke shtuar se i dëmtuari B. I. me rastin e kryerjes së këtyre veprave penale ka pësuar dëm, i cili në bazë të ekspertizës së inxhinier R. H. vlerësohet të jetë tridhjetëmijëekatërqind euro (30,400 €). I ka kërkuar gjykatës që lidhur me të akuzuarit të sjellë aktgjykim dënues dhe të i obligoj të njëjtit që të kompenzojnë dëmin e shkaktuar të dëmtuarit B. I..

Mbrojtësi i të akuzuarit B. M. av. Abit Asllani sipas zëvendësimit autorizues të avokates Teuta Zhinipotoku në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka eleboruar shkeljet e pretenduara që sipas tyre i përmban aktakuza, respektivisht i kanë vlerësuar disa aspekte të ligjshmërisë së kësaj aktakuze, poashtu e kanë kundërshtuar edhe ligjshmërinë e provave të përfshira në aktakuzë dhe të trajtuara edhe në shqyrtimin gjyqësor.

Mbrojtësi i të akuzuarit në fjalë ka deklaruar se me asnjë provë nuk është vërtetuar fakti se i mbrojturi i tyre e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar si dhe kanë kërkuar nga gjykata që në mungesë të provave dhe dëshmive të akuzuarin B. M. ta liroj nga akuza.

I akuzuari B. M. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit dhe se nuk ka çka të shtoj më tepër.

Mbrojtësi me autorizim i të akuzuarit K. K., av. Fitim Malokaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar se është fort i bindur se gjykata për të mbrojturin e tij do të sjellë aktgjykim lirues pasi që nuk ka prova që dëshmojnë se i njëjti të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Tutje mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar se në kohën për të cilën po akuzohet mbrojtësi i tij ka qenë në arrest shtëpiak për një rast të ndodhur në Prishtinë, të cilën masë i njëjti asnjëherë nuk e ka thyer, pasi që policia vazhdimisht ka bërë kontrolla se a është duke respektuar apo jo masën e arrestit shtëpiak..

Tutje mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar e pas një procesi maratonik të zhvilluar në këtë gjykatë është vërtetuar se nuk kemi të bëjmë më veprë penale të zjarrëvënies si dhe ka kërkuar nga gjykata që të mbrojturin e tij ta liroj nga akuza në mungesë të provave.

I akuzuari K.K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit dhe se nuk ka çka të shtoj më tepër

Mbrojtësi i të akuzuarit F. K. av. Arsim Bilalli në fjalën përfundimtare ka deklaruar se aktakuza e ngritur nga prokuroria nuk ka mundur të provojë se i mbrojturi i tij e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, pasi që nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë dhe se pa dyshim të bazuar mirë nuk mund të ketë edhe veprë penale dhe se për të ekzistuar kjo veprë penale duhet të përcaktohen qartë veprimet që duhet ndërmarrë e që në rastin konkret prokuroria nuk ka mundur të bëjë një gjë të tillë, duke shtuar poashtu se

provat të cilat janë paraqitur në aktakuzë janë të pabazuara dhe të papranueshme dhe se aktakuza e prokurorisë është ngritur në mënyrë hipotetike dhe duke u bazuar vetëm në supozime.

Tutje mbrojtësi i të akuzuarit ka deklaruar se në aktakuzë nuk është bërë përshkrimi i veprimeve inkriminuese nga ana e të mbrojturit të tij , duke theksuar se dëshmitë e dëshmitarëve të propozuara nga ana e prokurorisë janë irelevante dhe të pa rëndësihisme sa i përket të mbrojturit të tij si dhe ka kërkuar nga gjykata që të mbrojturin e tij ta liroj nga akuza në mungesë të provave.

I akuzuari F.K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit dhe se nuk ka çka të shtoj më tepër.

Vlerësimi i dëshmisë së dëshmitarëve dhe provave të tjera

Me rastin e vlerësimit të dëshmisë së të dëmtuarit G. U. gjykata gjeti se kjo dëshmi ishte mjaft e saktë dhe në përputhje të plotë edhe me provat e tjera materiale të paraqitura në këtë çështje penale dhe nga kjo dëshmi u vërtetua fakti mjaft i rëndësishëm dhe i pakontestueshëm se këto vepra penale janë kryer nga ana e të akuzuarve pasi që me dëshminë e të dëmtuarit, dëshmitarëve dhe provave të tjera materiale u vërtetua se të akuzuarit B. M. dhe K. K. në datën dhe vendin e përmendur në dispozitiv të këtij aktgjykimi respektivisht e kanë vënë zjarrin në restaurant “B.”, të shtytur nga i akuzuari tjetër F. K..

Gjithashtu gjykata gjeti se dëshmia e të dëmtuarit e dhënë në shqyrtimin gjyqësor ishte në përputhje të plotë edhe me deklaratimet e tij të dhëna në procedurën paraprake ku si në prokurori ashtu edhe në polici i dëmtuari i ka vërtetuar gjykatës faktin se vënies së zjarrit në restorantin e tij i kishte paraprirë një konflikt i mëhershëm që i akuzuari F. e ka pasur me një mysafir të lokalit të tij, si rezultat i së cilës i dëmtuari edhe është dashur të i largojë nga lokali, me ç'rast i akuzuari F. i është drejtuar me fjalët se “ *ka me ta kall lokalin* ”. Poashtu gjykata konstatoi se i dëmtuari me saktësi ka përshkruar tërë rrjedhën se si ka ndodhur ngjarja dhe se kjo dëshmi është në përputhje të plotë edhe me provat e tjera materiale të trajtuar në këtë çështje penale, andaj edhe të njëjtës gjykata i ka shpreh besimin e plotë.

Nga dëshmia e të dëmtuarit B. I. gjykata nuk ka mundur të vërtetoj ndonjë fakt që do të provonte në mënyrë të drejtëpërdrejtë kryerjen e kësaj vepre penale, por ky i dëmtuar-dëshmitar i ka provuar gjykatës faktin se e njeh të dëmtuarin G. U., pasi që me të ka raporte shoqërore dhe se

në restaurantin në fjalë ka pasur të vendosura paisje muzikore dhe se edhe atij i është shaktuar një dëm i konsiderueshëm material.

Edhe dëshminë e dëshmitarit S. S. gjykata e ka vlerësuar si të plotë, bindëse, reale dhe të njëjtës edhe i ka shpreh besimin e plotë për faktin se një dëshmi e tillë ishte në përputhje edhe me deklarin e dëshmitarit të dhënë në procedurën paraprake-polici, e poashtu kjo dëshmi ishte në përputhje të plotë edhe me dëshminë e të dëmtuarit, dhe provave të tjera materiale. Ky dëshmitar gjykatës i ka vërtetuar se i dëmtuari G. ka pas mosmarrëveshje me të akuzuarin F. disa netë përpara se të vihet zjarri në restaurant “B.”, duke shtuar poashtu se natën kritike vetura e tipit “M. G-C.” ka kaluar disa herë përpara restaurantit në fjalë, e që një veturë e tillë rezulton të jetë e F. U. me të cilin i akuzuari F. ka raporte shoqërore.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit T. D., gjykata poashtu gjeti se edhe dëshmia e këtij dëshmitari është e plotë, reale dhe bindëse, e për më tepër një dëshmi e tillë ishte në përputhje të plotë edhe me deklarin e tij të dhënë në Stacionin Policor si dhe me dëshmitë e të dëmtuarit G. U. dhe dëshmitarëve të tjerë. Edhe nga dëshmia e këtij dëshmitari gjykata ka vërtetuar se i njëjti kishte pas një mosmarrëveshje me të akuzuarin F. disa netë para kryerjes së veprës penale për shkak të së dashurës së të akuzuarit F., e cila edhe punonte si balerinë në restaurantin në fjalë. Andaj duke marrë për bazë ato që u thanë më lartë edhe dëshminë e këtij dëshmitari gjykata e ka vlerësuar si të besueshme dhe i ka shprehur besimin e plotë.

Dëshmitari R. Sh. i ka provuar gjykatës faktin se ai ka qenë i caktuar si mbrojtës sipas detyrës zyrtare në seancën dëgjimore për caktimin e paraburgimit ndaj të akuzuarit B. M. duke vërtetuar poashtu se sjellja e zyrtarëve policor ndaj të akuzuarit me rastin e intervistimit ka qenë korrekte dhe se nuk është ndikuar në ndonjë mënyrë të i akuzuari dhe poashtu gjykata edhe dëshminë e këtij dëshmitari e ka vlerësuar si reale, të plotë dhe në përputhje edhe me provat e tjera materiale dhe të njëjtës edhe i ka shprehur besimin e plotë.

Dëshmitari Z. M. gjykatës i ka provuar vetëm faktin se të gjitha procedurat në raport me të akuzuarit janë kryer konform dispozitave ligjore dhe në pajtim dhe me urdhërat e prokuorit të shtetit dhe se procedura e intervistimit të të akuzuarve ka shkuar konform dispozitave dhe procedurave ligjore.

Gjykata me një vëmendje të posaçme ka vlerësuar dhe analizuar edhe dëshminë e dëshmitarëve të mbrojtjes F. K., Sh. H., F. R dhe E. A., mirëpo sa u përket këtyre dëshmive gjykata gjeti se ato janë në kundërshtim me dëshminë e dëshmitarëve S. S.T. D., R. Sh. të dëmtuarit G. U. si dhe me provat e tjera materiale të paraqitura në këtë çështje penale.

Gjithashtu deklarata dëshmitarit F. K. binte ndesh edhe me deklaratën e dhënë nga A. N.- “S.”, kjo për faktin se në deklaratën e dhënë në Stacionin Policor me datë 28.08.2020, dëshmitari F. K. ka deklaruar se pas konfliktit që e kanë pasur në restaurant “B.” dhe pasi që janë larguar nga takimi që e kanë pas në villa “M.” nga aty kanë shkuar në Fushë Kosovë, tek banesa e të dashurës së të akuzuarit F., A. N., e cila edhe ka qenë prezente në banesë, deklarim ky që ishte në mospërputhje me deklaratën e dëshmitares A. N. e dhënë në prokurori me datën 02.09.2020, ku ka deklaruar se nuk ka qenë e pranishme në banesën e saj kur ka shkuar i akuzuari F. dhe se nuk e njeh asnjërin nga shokët e të akuzuarit F..

Gjithashtu me rastin e vlerësimit të këtyre dëshmive gjykata gjeti se të njëjtat janë përcjellë edhe me kundërthënie me provat e tjera materiale. Kështu dëshmitari F. K. në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor lidhur me konfliktin që i ka paraprirë zjarrëvines ka deklaruar se nuk i kujtohet nëse mbrëmjen kur ka ndodhur ky konflikt i akuzuari F. i është ofruar apo jo ndonjë personi-mysafiri në tavolinë, por një deklarim i tillë binte ndesh me dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ku në pyetjet e gjyqtarës së vetme gjykuese dëshmitari ka deklaruar se “*po F.i i është ofruar një tavoline, por nuk e di se çka kanë biseduar*”, e gjithashtu një deklarim i tillë binte ndesh edhe me deklaratën e tij të dhënë në Stacionin Policor me datën 28.08.2020, ku ka deklaruar se derisa ai ishte drejtuar për tek dera e lokalit ka vërejtur që i akuzuari F. kishte shkuar tek tavolina e personit që kishte diskutuar më herët në koridor tek toaletet (duke iu referuar dëshmitarit T. D.).

Gjykata me një kujdes të shtuar e ka vlerësuar edhe dëshminë e dëshmitarit Sh.H., por nga kjo dëshmi gjykata nuk ka mundur të provojë nëse të akuzuarit kanë qenë apo jo të përfshirë në kryerjen e kësaj vepre penale, madje dëshmitari ka pasur luhatje edhe në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor me datën 15.02.2022. Kështu dëshmitari në një pjesë të dëshmisë së tij ka deklaruar se nuk i kujtohet se si është informuar për zjarrvënien në resaturant “B.”, përderisa në një pjesë tjetër të dëshmisë së tij deklaroi se atë mbrëmje ka qenë duke u kthyer nga Shkupi dhe e ka parë restaurantin në fjalë duke u djegur.

Se ka pasur luhatje në dëshminë e dëshmitarit vërtetohet edhe me faktin se në deklaratën e dhënë me datën 26.08.2020, dëshmitari Sh. H. ka deklaruar se në orët e hershme të mëngjesit para se të udhëtoj për në Shkup është takuar me F. U. dhe F. K. te pompa e derivateve “I. P.”, ndërsa kur është pyetur nga prokurorja lidhur me këtë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar *“F... e di që e kam takuar një ditë përpara, F.i nuk më kujtohet”*.

Edhe me rastin e vlerësimit të dëshmisë së dëshmitarit F.R, gjykata gjeti mospërputje në deklaratimet e tij, kështu në dëshminë e tij dëshmitari në pyetjet e mbrojtësit të të akuzuarit B. M. ka deklaruar se pas takimit në villa “M.” nuk e di se për ku kanë vazhduar më pas B.i, F.i, E. dhe F., por një deklaram i tillë binte ndesh me deklaratën e tij të dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj ku ka deklaruar se pasi e ka dërguar të akuzuarin F. në Fushë Kosovë, bashkë me F. me veturën e tij kanë shkuar në “H. P.”, kanë darkuar dhe më pas ka shkuar te pompa e derivateve “I.P” për të marrë veturën e tij ku është takuar edhe me Sh. H.. Një fakt të tillë dëshmitari e ka pohuar edhe në shqyrtimin gjyqësor pasi që është ballafaquar me një deklaratë të tillë, ku ka deklaruar se *“po është e vërtetë se jam takuar me Sh.... dhe kam qëndruar me F. U.”*.

Tutje në deklaratën e dhënë në polici ky dëshmitar ka deklaruar se me datën 05.07.2020, përkatësisht 06.07.2020-pas mesnatës nuk janë takuar fare me të akuzuarit e as me të akuzuarin F., mirëpo gjykata gjeti se nga provat materiale vërtetohet e kundërta pasi që të akuzuarit janë takuar te villa “M.”, e poashtu kjo vërtetohet edhe në bazë të videoincizimeve të nxjerra nga kamerat e pikës së derivateve “I. P.” të datës 06.07.2020, rreth orës 01:45, ku shihet mjaftë qartë se aty ka qenë edhe i akuzuari F. K. bashkë me F. U. dhe të njëjtit dalin nga vetura e këtij të fundit, takohen me Sh. H., i cili arrin me veturën e tij dhe shihet se aty shumë afër ka qenë e parkuar edhe vetura e F. R e markës “P.”, ngjyrë kafe e mbyllët dhe e gjithë kjo për gjykatën vërteton faktin se dëshmitari nuk e ka dëshmuar të vërtetën në shqyrtimin gjyqësor.

Me një vëmendje dhe kujdes të shtuar gjykata e ka vlerësuar dhe analizuar edhe dëshminë e dëshmitarit E. A. mirëpo edhe kjo dëshmi e këtij dëshmitari ishte në kundërrthënie edhe me provat e tjera materiale. Në deklaratën e dhënë në polici me datën 27.07.2020 ka deklaruar se në villa M. ka qenë bashkë me F., të akuzuarin B. dhe F. dhe se me ta nuk ka qenë edhe i akuzuari F. K. përderisa në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se bashkë me ta ka qenë edhe i akuzuari F. K. fakt ky që dëshmon se dëshmitari ka pasur luhatje në qëndrimin e tij.

Poashtu gjykata me rastin e vlerësimit të dëshmisë së dëshmitarëve F. K., Sh. H., F. R dhe E. A. pati parasysh edhe faktin se këta dëshmitarë janë në mardhënie shoqërore me të akuzuarit, andaj për gjykatën ishte qartë se këta dëshmitarë në dëshmitë e tyre kanë qenë subjektiv, respektivisht edhe e kanë mbajtur anën e të akuzuarve me qëllim që të njëjtit t'i lirojnë nga përgjegjësia penale. Andaj duke marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë, gjykata dëshmitë e këtyre dëshmitarëve i vlerësoi si pjesërisht të besueshme dhe të njëjtave nuk u shprehi besimin e plotë.

Nga leximi i deklaratave të A. N. dhe E. P. gjykata nuk ka mundur të vërtetoj ndonjë fakt të drejtpërdrejtë lidhur me kryerjen e këtyre veprave penale, përveç faktit se A. ishte e dashura e të akuzuarit F., kishte punuar në restaurant "B." dhe se kishte qëndruar një kohë në banesën e dëshmitares E. P.. Për më tepër gjykata gjeti se këto deklarata nuk përputheshin me njëra tjetrën për faktin se përderisa dëshmitarja A. ka deklaruar se E. ka qëndruar bashkë me të dhe të akuzuarin F. në banesën e tyre natën kritike, ky fakt është mohuar nga kjo e fundit, e cila ka deklaruar se vetëm i ka përshëndetur dhe ka vazhduar në dhomën e saj dhe nuk ka qëndruar me ta. Andaj duke marrë për bazë këto fakte gjykata deklarimet e këtyre dëshmitareve i ka vlerësuar si pjesërisht të besueshme dhe nuk u ka shpreh besimin e plotë.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit B. M..

Gjykata me një vëmendje të posaçme dhe kujdes të shtuar e ka vlerësuar dhe analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit B. M. të dhënë në shqyrtimin gjyqësor, mirëpo pretendimin e të akuzuarit se ai nuk ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, gjykata e vlerësoi si jo real dhe jo të besueshëm ngase një pretendim i tillë nuk mund të vërtetohej me asnjë provë bindëse dhe për më tepër ky pretendim është në kundërtënie të plotë me dëshminë e të dëmtuarit G. U., me dëshminë e dëshmitarëve si dhe provave të tjera materiale. Poashtu si jo real gjykata e vlerësoi edhe pretendimin e të akuzuarit se deklarata e dhënë në Stacionin Policor me datën 31.07.2020 është marrë me përdorimin e dhunës nga ana e zyrtarëve policor, e kjo për faktin se i akuzuari nuk ka mundur të provojë me asnjë provë se është ushtruar dhunë nga ana e zyrtarëve policor me rastin e intervistimit të tij, pa harruar të përmendet edhe fakti se edhe në deklarataën e dhënë në prokurori me datën 11.09.2020, i akuzuari ka deklaruar se nuk posedon asnjë raport mjekësor apo provë tjetër me të cilën do dëshmonte se mbi të është ushtruar dhunë nga ana e zyrtarëve policor apo ndonjë raport mjekësor me të cilin do dëshmonte lëndimet që i ka pësuar ashtu siç edhe pretendonte, ndërsa lidhur me këtë fakt në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se posedon raport mjekësor.

Edhe me rastin e vlerësimit të mbrojtjes së të akuzuarit B. M., gjykata gjeti kundërthënie dhe mospërputhje, kështu në mbrojtjen e tij në shqyrtimin gjyqësor i akuzari ka deklaruar se nuk është e vërtetë se në takimin që e kanë pasur te villa “M.” është biseduar për zjarrvënien në restaurant “B.”, por një dëshmi e tillë binte ndesh me deklaratën e dhënë me datën 30.07.2020 në praninë e mbrojtësit të tij av.R. Sh.ka deklaruar *“ ka diskutuar F.i ka dhënë propozimin që të shkojmë e ta kallim lokalin “B.”, në atë moment F... i tha unë nuk të përkrahi.... ”*

Gjykata mbrojtjes së të akuzuarit B. M. nuk i ka shpreh besimin e plotë edhe për faktin se deklarimi i tij në shqyrtimin gjyqësor ishte në kundërshtim të plotë me deklaratën e dhënë në polici me datën 31.07.2020, ku në këtë deklaram i akuzuari në tërësi e ka përshtuar kryerjen e kësaj veprë penale duke u nisur nga takimi i tyre në villën “M.” me datë 05.07.2020, i cili takim edhe i ka paraprirë kryerjes së këtyre veprave penale, e ku më pas rreth orës 03:00, i akuzuari F. i ka shkruar të akuzuarit B. në rrjetin social “Snapchat” se *‘hajde jemi tu shku unë, ti e K. me kall lokalin’*, kurse ky i është përgjigjur me *“okej”*. Më tej në këtë deklaratë potencon faktin se më pas të akuzuarit F. e K. K. kanë shkuar me veturën “Golf.”, e kanë marrë atë dhe janë nisur për të vënë zjarrin në restaurant “B.” dhe se gjatë gjithë rrugës kanë bërë plane se kush do ta vëjë zjarrin e kush do të qëndroj në veturë.

Gjithashtu i akuzuari në këtë deklaratë e ka sqaruar gjithë ngjarjen duke shtuar se para se të mbërrinin tek vendi i ngjarjes fillimisht janë ndalur tek një pikë e derivateve “R. P.”, në fshatin B. në komunën e Lipjanit, ku i akuzuari K. e kishte mbushur një bidon dhjetë litërsh me benzinë, pastaj kanë shkuar të restoranti “B.”, janë parkuar rreth një kilometër larg, aty kanë qëndruar rreth gjysmë ore, e kanë vëzhguar situatën, ka dalë jashtë për të pirë cigare dhe pasi janë siguruar se nuk ndodhet askush brenda, i akuzuari B. bashkë me të akuzuarin K. përmes dritares së toaletit kanë hyrë brenda, bidonin me benzinë e ka mbajtur i akuzuari K., i njëjti e ka spërkatur brendësinë me benzinë, më pas i akuzuari B. i ka dhënë të akuzuarit K. disa paloma, ai e kishte marrë bidonin e zbrazur dhe ishte nisur për të dalë, ndërsa i akuzuari K. i ka ndezur palomat dhe i ka vënë në tokë ku më pas i gjithë vendi kaplohet nga zjarri.

Në këtë deklaratë i akuzuari B. M. ka pohuar edhe faktin se pasi e kanë vënë zjarrin përsëri kanë dalë nga dritarja e toaletit dhe kanë shkuar në veturë ku i priste i akuzuari F., i cili edhe ka qëndruar në veturë gjatë tërë kësaj kohe.

Edhe pse i akuzuari më vonë e ka mohuar këtë deklaratë, gjykata të njëjtën e ka trajtuar si provë mjaft të rëndësishme për vërtetimin sa më të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike për më tepër një deklaratë e tillë është në përputhje të plotë me dëshminë e të dëmtuarit, dëshmitarëve, por edhe të gjitha provat e tjera materiale. Për më tepër për gjykatën mohimi i kësaj deklarate nga ana e të akuzuarit ishte kryekëput në drejtim të shmangies së përgjegjësisë penale, e gjithashtu i akuzuari në këtë deklaratë në mënyrë të hollësishme dhe të detajuar e ka sqaruar gjithë ngjarjen, andaj për gjykatën ishte e pakuptueshme dhe e paqartë se nëse i akuzuari B. M. nuk ka marrë pjesë në kryerjen e kësaj vepre penale, atëherë si ishte e mundur që të dijë kaq shumë detaje dhe hollësi për kryerjen e kësaj vepre penale, kur kihet parasysh edhe fakti se në kohën kur është dhënë një deklaratë e tillë rasti ka qenë krejtësisht në fazën fillestare të tij.

Për më tepër gjykata gjen se kjo deklaratë ishte në përputhje të plotë edhe me provën materiale-videoincizimin e nxjerrë nga kamerat e sigurisë së restaurant “B.”, ku nga ky videoincizim vërehet qartë se të akuzuarit në datën që i referohet aktakuza me veturën e tipit “Golf .” shkojnë te resturanti në fjalë, aty qëndrojnë një kohë dhe më pas dalin nga vetura, ku i akuzuari B. M. del nga ana e djathtë te pjesës së pasme të autmojetit, respektivisht nga ana prapa pasagjerit, kurse i akuzuari K. K. del nga dera e përparme nga ana e pasagjerit, respektivisht ka qenë i ulur në ulësen e pasagjerit, kurse i akuzuari F. K. ka qëndruar ulur në ulësen e shoferit. Më pas të njëjtit futen brenda në restaurant nga dritarja e toaletit dhe i ndërmarrin të gjitha veprimet që i akuzuari B. M. i ka përshkruar në deklaratën e datës 31.07.2020.

Se i akuzuari B. M. ka bërë përpjekje të vazhdueshme për t’iu shmangur përgjegjësisë penale për veprën për të cilën akuzohet vërtetohet edhe me faktin se ai në ditën kur ka ndodhur ngjarja është larguar nga Kosova për në Shqipëri bashkë me F. U., e ky fakt provohet edhe me provën materiale, repektivisht hyrje-daljet e nxjerra nga Qendra Kombëtare për Menaxhimin Kufitar, konkretisht pika kufitare “Morina” në kufirin Kosovë-Shqipëri nga ku rezulton se i akuzuari B. M. bashkë me F. U. me datën 06.07.2020, rreth orës 18:09 kalojnë kufirin nga Kosova për në Shqipëri, ku ka qëndruar dy ditë dhe më pas është kthyer në Kosovë me datën 08.07.2020, në orën 15:06.

Fakti se i akuzuari B. M. me kalimin e tij në Shqipëri ka pas për qëllim shmangien e përgjegjësië penale për gjykatën vërtetohet edhe nga mbrojtja e tij e dhënë në shqyrtimin gjyqësor. Konkretisht kur është pyetur se kur dhe si ka kuptuar për zjarrin e vënë në restaurant “B.”, i akuzuari ka deklaruar “...menjëherë të nesërmen e kam kuptuar nga F. U., ai erdh tek banesa

ime dhe më ka treguar që është djegur restaurant “B.” dhe ai e kishte kuptuar nga Sh.H.”. Lidhur me këtë fakt për gjykatën ishte e paqartë se nëse i akuzuari nuk ka pasur gisht në zjarrin e vënë në restaurantin në fjalë, atëherë pse është dashur të informohet nga F. U. lidhur me zjarrin dhe atë pikërisht të nesërmen pas ndodhjes së rastit, e më i pakuptueshëm ishte fakti se për çfarë arsye i akuzuari menjëherë pas marrjes së këtij informacioni është nisur për në Shqipëri.

Kryerjen e kësaj vepre penale i akuzuari B. M. e ka pranuar edhe në seancën dëgjimore për caktimin e masës së paraburgimit e mbajtur në Gjykatën Themelore në Ferizaj me datën 21.08.2020, ku në këtë seancë ka deklaruar se kryerjen e kësaj vepre penale e ka pranuar edhe në deklaratën e dhënë në Stacionin Policor në Ferizaj.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit K. K.

Më të njëjtën vëmendje dhe kujdes të shtuar gjykata e ka vlerësuar dhe analizuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit K. K. i cili vazhdimisht është thirrur në atë se në kohën kur ka ndodhur ngjarja ai ka qenë në arrest shtëpiak nga data 14.06.2020 e deri më 14.08.2020 sipas aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Edhe për gjykatën nuk ishte kontestuese se i akuzuari gjatë kësaj kohe ka qenë nën masën e arrestit shtëpiak, mirëpo për gjykatën shfrytëzimi i arrestit shtëpiak si alibi nga ana e të akuzuarit ishte i pabazë, pasi që nga provat materiale të kësaj çështje penale, respektivisht nga provat e nxjerra nga kamerat e sigurisë së të akuzuarit në fshatin e tij G., komuna e Prishtinës vërtetohet se i njëjti e ka thyer masën e arrestit shtëpiak, pasi që në një pjesë të këtij videoincizimi dëgjohet i akuzuari K. ku i drejtohet djalit të tij me fjalët “*kur të vet policia mos i trego që kemi shku te lodrat*”, e këtë fakt, pra të thyerjes së arrestit shtëpiak dhe dërgimit të djalit të tij te lodrat i akuzuari e ka potencuar edhe në deklaratën e tij të dhënë në prokurori, ku në prezencën e avokatit mbrojtës ka deklaruar se këtë veprim e kishte ndërmarrë “*për hatër të djalit*”, fakt ky që për gjykatën dëshmon se i akuzuari e ka thyer masën e arrestit shtëpiak dhe kështu bie poshtë edhe alibia e tij.

Se i akuzuari K. K. e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet për gjykatën vërtetohet edhe nga prova materiale e trajtuar në këtë çështje penale, konkretisht nga Raporti i Njësisë të Teknikës Kriminalistitke i datës 20.08.2020 lidhur me bastisjen e kryer në shtëpinë e të akuzuarit në fshatin G., komuna e Prishtinës, ku i njëjti edhe ka qëndruar, me ç’rast nga ky raport rezulton se në shtëpinë e të akuzuarit janë gjetur armë, bomba dore, fishek, paisje të ndryshme, dokumente dhe gjatë këtij kontrolli në një kotec të shpezëve janë gjetur dy duksa, njëri ngjyrë hiri, tjetri i zi,

të dy me kapela që ishin të fshehur në këtë objekt, e ky fakt vërtetohet edhe me raportin e policisë për bastisjen e shtëpisë së të akuzuarit K. K. të datës 20.08.2020 si dhe me vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve.

Me rastin e krahasimit të këtyre duksave me ata që i kanë pas veshur personat që e kanë vënë zjarrin e të cilët shihen nga kamerat e sigurisë së restaurant “B.”, vërtetohet se këta duksa janë shumë të ngjashëm, madje pothuajse identik. Madje fakti se këta duksa i kanë pasur veshur të akuzuarit ditën kritike provohet edhe nga deklarata e të akuzuarit B. M. e dhënë me datën 31.07.2020 ku ka deklaruar se pas kryerjes së veprës penale i akuzuari K. i kishte thënë që t’i hiqte rrobat që i ka pas veshur atë natë e sipas tij ato rroba i kishte marrë me vete K..

Prandaj duke i marrë për bazë të gjitha që ato u thanë më lartë, gjykata mbrojtjes së të akuzuarit K. K. nuk i ka shprehur besimin e plotë.

Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit F. K.

Edhe mbrojtjen e të akuzuarit F. K. gjykata e ka vlerësuar dhe analizuar me kujdes të shtuar, mirëpo edhe mbrojtjes së këtij të akuzuari gjykata nuk i ka shprehur besimin e plotë pasi që e njëjta ishte në kundërshtim me dëshminë e të dëmtuarit, dëshmitarëve S. S. Z. M., R. Sh. T. D., B. I. si dhe me provat e tjera materiale.

Gjithashtu gjykata gjatë vlerësimit të mbrojtjes së këtij të akuzuari gjeti se e njëjta ishte në mospërputhje me deklaratat e tij të dhëna në procedurën parprake. Në deklaratën e dhënë në polici me datën 09.07.2020, i akuzuari kishte deklaruar se me datën 05.07.2020 kishte qenë me shokët e tij në villa “M.”, aty ka qëndruar deri pas mesnatës të datës 06.07.2020 dhe më pas nga aty ka shkuar tek banesa e të dashurës së tij “S.” që gjendet në Fushë Kosovë dhe aty ka qëndruar gjatë tërë kohës deri në orën 13:00 të datës 06.07.2020, madje kur është pyetur lidhur me këtë në polici kishte deklaruar *“po jam shumë i sigurtë se gjatë kësaj kohe kam qenë në Fushë Kosovë, në banesën e të dashurës time të cilat mund të i verifikoni nga kamerat e sigurisë së banesës dhe lokaleve që gjenden afër...”*, por një deklaram i tillë i tij binte ndesh me deklaratën e dhënë në prokurori me datën 08.10.2020 ku ka theksuar se pasi që ka shkuar te banesa e të dashurës së tij, pas një ore ka dal për të blerë pije dhe ishte takuar me shokët e tij. Fakti se deklarimi i të akuzuarit se ai ka qëndruar pa dalë fare në banesën e të dashurës së tij është i pavërtetë vërtetohet edhe me

videoincizimet e nxejrra nga kamera e sigurisë nga pompa e derivateve “I. P.” të datës 06.07.2020 rreth orës 01:45, ku qartë shihet i akuzuari F. K. bashkë me F. U. dhe Sh. H..

Gjithashtu deklarami i të akuzuarit se ai natën kritike ka qëndruar tërë kohën në banesën e të dashurës së tij A. N.-S. është i pabazë vërtetohet edhe nga deklaratat e kësaj të fundit e dhënë në Prokurorinë Themelore në Ferizaj, ku ka theksuar faktin se kur ka shkuar të nesërmen në banesën e saj i akuzuari F. veç ka qenë aty.

Gjithashtu i akuzuari ka deklaruar se pas takimit që e ka pasur me F. U. dhe Sh. H. te pika e derivateve “I. P.”, pra me datën 06.07.2020 ka vazhduar për në fshatin G. për ta vizituar të akuzuarin K. K. ndërsa kur është pyetur nga mbrojtësi i tij lidhur me arsyen e kësaj vizite, i akuzuari ka deklaruar se aryeja e vizitës ka qenë për ta pyetur se a ka qenë në dijeni për ngjarjet e datës 04.07.2020. Një deklarami i tillë gjykatës i provonte edhe më shumë faktin se i akuzuari F. i ka shtytë të akuzuarit B. dhe K. K. për të kryer veprën penale të zjarrvënies pasi që për gjykatën ishte e paqartë se pse i akuzuari F. është dashur të presë datën 06.07.2020 për të diskutuar me të akuzuarin K. lidhur me këtë çështje kur këtë ka mundur ta bëjë shumë më përpara, e edhe më e paqartë ishte fakti se pse i akuzuari F. është dashur ta bëjë këtë vizitë në orët e vona, konkretisht pas mesnate dhe gjykata vlerëson se në bazë të provave materiale rezulton se kjo vizitë e të akuzuarit F. tek i akuzuari K. është bërë për tu marrë vesh dhe për të përgatitur planin e zjarrvënies në restaurant “B.”.

Për gjykatën ishte i pakontestueshëm fakti se i akuzuari F. ka pasur motiv për të shtytë të akuzuarit B. M. dhe K. K. për të kryer veprën penale të zjarrvënies dhe se ky motiv ka qenë pikërisht grindja-konflikti që e ka pas i akuzuari F. me pronarin e restaurant “B.”, të dëmtuarin Gëzim dhe sigurimin e këtij restoranti, e që një fakt i tillë-ai i ekzistimit të konfliktit nuk është mohuar as nga dëshmitarët, por as nga të akuzuarit, ku i dëmtuari ka potencuar edhe faktin se në natën kur ka ndodhur konflikti i akuzuari F. i është drejtuar me fjalët *“ki me pa ti kush jam unë, ka me ta kall lokalin”*, duke shtuar këtu edhe faktin se i akuzuari B. M. në deklaratën e tij të dhënë më datën 30.07.2020 ka deklaruar se propozimi për të vënë zjarrin në restorantin në fjalë ka qenë i të akuzuarit F. K.. Një fakt të tillë i akuzuari B. e ka potencuar edhe në deklaratën e dhënë me datën 31.07.2020, ku në mënyrë të detajuar dhe të hollësishme e ka përshkruar në tërësi rastin e ndodhur duke theksuar se pikërisht ka qenë i akuzuari F. K. ai i cili u ka thënë që të shkojnë ta djegin restaurant “B.”.

Fakti se i akuzuari F. K. e ka organizuar dhe i ka shtytë të akuzuarit B. dhe K. në kryerjen e kësaj vepre penale vërtetohet edhe me provën materiale-videoincizimin nga villa “M.” i datës 05-06.07.2020 ku shihet se të akuzuarit janë takuar me disa shokë të tjerë dhe në këtë takim i akuzuari F. ka bërë planet për vënien e zjarrit në restaurant “B.”, ku në këtë videoincizimi shihen të akuzuarit të ulur në një tavolinë dhe derisa bisedojnë, e se në këtë takim është diskutuar për kryerjen e këtyre veprave penale është vërtetuar edhe nga i akuzuari B. M. i cili në deklaratën e tij të dhënë me datën 30.07.2020 kishte deklaruar se F.i ka propozuar që ta vënë zjarrin në resturant “B.”, pa harrur të përmendet edhe fakti se në deklaratën e dhënë me datën 31.07.2020 i akuzuari B. në tërësi e ka pranuar kryerjen e kësaj vepre penale, duke e inkriminuar edhe të akuzuarin F. K.si shtytës në kryerjen e këtyre veprave penale.

Duke u bazuar në provat dhe të gjeturat e tjera, gjykata mbrojtjes së të akuzuarit F. K. nuk i shprehi besimin e plotë pasiqë një deklaram i tillë nuk mund të provohej me asnjë provë bindëse, reale dhe të pakontestueshme dhe si i tillë është i orientuar në fshehjen e veprimeve inkriminuese të të akuzuarit dhe në zvogëlimin e përgjegjësisë së tij penale.

Vlerësimi i tezave të mbrojtjes së të akuzuarve

Gjykata në këtë çështje penale me një vëmendje të posaçme e ka vlerësuar edhe versionin e avokatëve mbrojtës të të akuzuarve.

Pretendimet e avokatëve mbrojtës se nga provat e shqyrtuara në shqyrtimin gjyqësor dhe nga dëshmia e dëshmitarëve nuk vërtetohet në mënyrë të sigurt se të mbrojturi të tyre i kanë kryer këto vepër penale, gjykata i vlerësoi si të paqëndrueshme pasiqë i dëmtuari G. U. dhe dëshmitarët, dëshmive të të cilëve gjykata u ka shpreh besimin e plotë, në mënyrë të drejtë dhe të pakontestueshme provuan faktin se të akuzuarit B. M. dhe K. K. e kanë vënë zjarri në restaurant “B.”, të shtytur nga i akuzuari F. K. fakt ky i cili mbështetet edhe në provat materiale që janë shtjelluar në këtë çështje penale

Poashtu si të paqëndrueshme gjykata e ka vlerësuar edhe pretendimin e mbrojtësve të të akuzuarve se të njëjtit gjykata duhet t’i lirojë nga akuza në mungesë të provave, pasiqë në rastin konkret gjykata vlerëson se me dëshmitë e dëshmitarëve dhe provave të tjera materiale është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar.

Të gjeturat e gjykatës, matja dhe shqiptimi i dënimit

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurve B. M., K. K. dhe F. K. ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprave penale për të cilat janë akuzuar, ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi të përshkruar në datën, vendin, kohën dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese gjykata pati parasysh pasojën e shkaktuar nga këto vepra penale, shkallën e lartë të dashjes së të akuzuarve për kryerjen e kësaj vepre penale, motivin e ulët për kryerjen e kësaj vepre penale, përkatësisht faktin se këto vepra penale janë kryer me qëllim të hakmarrjes, faktin se këto vepra penale janë kryer pas një plani të mirëorganizuar dhe poashtu gjykata vlerësoi shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprave penale.

Gjykata me rastin e vlerësimit të rrethanave rënduese dhe lehtësuese gjykata pati parasysh edhe faktin se i akuzuari B. M. ka qenë edhe më parë i dënuar me kryerjen e veprave penale që evidentohet me numër 2019:128431 dhe 2020:036205.

Poashtu gjykata gjeti se edhe i akuzuari K. K. është dënuar më parë për vepra penale në bazë të aktgjykimin 2019:150769.

Andaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarve u shqiptoi dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventives speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprave penale, rrethanave të kryerjes së veprave penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarve.

Sa i përket pjesës së dytë (II) të dispozitivit, përkatësisht pjesës refuzuese, prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se heq dorë nga akuza ndaj të akuzuarit F. K. për veprën penale zjarrvënia nga neni 322 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK-së, pasi që nuk është provuar se i njëjti ka kryer këtë vepër penale, mirëpo është provuar se i njëjti i ka shtytë dy të akuzuarit e tjerë B. M. dhe F. K. në kryerjen e këtyre veprave penale.

Pasi që prokurorja e shtetit ka heq dorë nga ndjekja penale gjykata duke marrë për bazë këto rrethana vendosi që të akuzuarin ta lirojë nga akuza për këtë vepër penale dhe të sjellë aktgjykim refuzues ashtu siç është theksuar edhe në dispozitivin **II** të këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit dhe arrestit shtëpiak në dënimin e shqiptuar është marrë konform dispozitave të nenit 79 të KPRK-së

Vendimi mbi shpenzimet paushallë per dispozitivin **I** është marr në kuptim të dispozitës së nenit 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet paushallë per dispozitivin **II** është marr në kuptim të dispozitës së nenit 454 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi realizimin kërkesës pasurore-juridike është marr në kuptim të nenit 463 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi konfiskimin është marrë konform nenit 115 të KPPRK-së.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Departamenti Pergjithshem-Divizioni Penal,
P.nr.983/20 datë 19.09.2022

Zyrtari Ligjor,

Ymri Ibrahim

Gjyqtarja e vetme gjykuese,

Hakile Ilazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.